

VENDIM
Nr. 702, datë 6.12.2023

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2024, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2024, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 71 217 100 (shtatëdhjetë e një milionë e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind) lekë, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)
ANEKSI NR. 1

Plani i shpenzimeve për vitin 2024

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2024 (lekë)
1	Pagat dhe shtesat e tjera	47 252 500
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	7 507 600
3	Shërbime e furniturë	13 957 000
4	Investime	2 500 000
	TOTALI	71 217 100